



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

VENDIM

Nr. 2, datë 20.02.2025

PËR

MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM BURIMI UJOR
NËNTOKËSOR PËR QËLLIME INDUSTRIALE, TË SUBJEKTIT
“SABINA 2020” SH.P.K., ME VENDNDODHJE: BELTOJ, NJËSIA
ADMINISTRATIVE BERDICË, BASHKIA SHKODËR, QARKU
SHKODËR.

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, dhe Vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime industriale, të subjektit “Sabina 2020” sh.p.k., me vendndodhje: Beltoj, Njësia Administrative Berdicë, Bashkia Shkodër, Qarku Shkodër.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Akuiferi që kërkohet të shfrytëzohet: Trupi ujor i shpimit nr.1/2009 (Beltoj)

Koordinatat e vendndodhjes së shpimit (KRGJSH)

Pus Shpimi nr.1/2009 (Beltoj)

X=460189;

Y=4654113;

Z=10.78 m.m.n.d

Koordinatat e vendndodhjes së pikës ku do të shfrytëzohet uji (KRGJSH)

X=460194;

Y=4654115;

Z=10.78 m.m.n.d

Qëllimi i përdorimit të ujit: Për qëllime industriale (larje të inerteve në nyjen e fraksionimit dhe prodhim betoni)

Prurja e ujit të kërkuar: $Q = 2.6 \text{ l/sek}$

Prurja mesatare vjetore: $Q_{\text{mes-vjet}} = 3.5 \text{ l/sek}$

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH)

X=460218;

Y=4654114;

Z=10.78 m.m.n.d

Prurja që shkarkohet: $Q=2.5 \text{ l/s}$

3. Burimi ujq të përdoret vetëm për larjen e inerteve sipas kontatës së furnizimit Nr. Rep 4441, Nr. Kol 2022, datë 18 .10.2024

4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBK DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

